



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:055998
Datë: 23.06.2022
Numri i dokumentit: 03166388

PPP.nr.125/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, Gjyqtarja Mirjeta Shala, me bashkëpunëtorin profesional Driton Sadiku, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kolegji A. Xh. – U., me seli në Ferizaj, rr.”F. N.”, nr..., kundër debitorit A. D. B.I, me seli në Gjakovë, rr.”S.”, p.n, për përmbarim sipas dokumentit të besueshëm - faturave, për borxh në vlerë prej 7,900.00.-€, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.054/21 të datës 22.02.2021, të Shoqërisë Përmbarimore “Metaj Law”, me seli në Prishtinë, jashtë seance, me datën 22.06.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit A.D. B.I, me seli në Gjakovë, i ushtruar kundër Urdhrit të Shoqërisë Përmbarimore “Metaj Law”, me seli në Prishtinë, P.nr.054/21 të datës 22.02.2021, mbi lejimin e përmbarimit.

II. Ankesa kundër këtij Aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore, përveç nëse janë dhënë garancitë në shumën e plotë të detyrimit në të holla.

A r s y e t i m

Me urdhrin e Shoqërisë Përmbarimore “Metaj Law”, me seli në Prishtinë, .nr.054/21 të datës 22.02.2021, është lejuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorit Kolegji A.Xh. – U., ndaj debitorit A. D. B.I, për përmbarim sipas dokumentit të besueshëm-faturave me numër-.....-..... e datës 11.11.2019,-.....-.....e datës 29.11.2019,i datës 31.12.2019, 2-220-002-20 i datës

08.01.2020,i datës 07.02.2020,i datës 09.03.2020,i datës 01.04.2020, i datës 01.05.2020,i datës 01.07.2020,..... i datës 01.06.2020,i datës 01.08.2020,i datës 01.09.2020,i datës 01.10.2020,i datës 02.11.2020 dhe.....i datës 01.12.2020, për borxhin e përgjithshëm në vlerë prej 7,900.00.-€, me kamat ligjor, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kundër Urdhrit mbi lejimin e përbarimit, debitori A. D. B.I, brenda afatit ligjorë, me datën 02.04.2021, përmes postes, ka parashtruar prapësim te Shoqëria Përbarimore “Metaj Law”, me seli në Prishtinë përmes të cilit ka theksuar se: debitori konteston në tërësi urdhrin për përbarim dhe këtë prapësim e bazon në nenin 71 par.1.1 dhe 1.6 të LPP-së, pasi që dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe kreditori nuk është i autorizuar të kërkoj përbarimin në bazë të dokumentit përbarues. Faturat e lëshuara nga kreditori nuk kanë tipare të përbarueshmërisë se pse nuk është e përshtatshme për përbarim në kuptim të nenit 27 par.1 të LPP-së. Vlen të theksohet se faturat e nënshkuara dhe të pranuar janë paguar, çka nuk është kontestuese as për kreditorin, i cili e pranon që një pjesë e faturave janë paguar, pa i specifikuar se cilat prej tyre, ndërsa faturat tjera që nuk janë nënshkruar sigurisht që nuk janë paguar nga ana e debitorit. Faturat që janë të pa nënshkuara nuk janë në përputhje me udhëzimin administrativ nr.15/10 për zbatimin e ligjit mbi administratën tatimore të Kosovës. Gjykatës i propozoi që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri P.nr.054/21 i datës 22.02.2021, i përbaruesit privat Kushtrim Metaj.

Kreditori Kolegji A. Xh. – U., me datën 12.03.2021, ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, me të cilin ka theksuar se pretendimet e debitorit në prapësim janë të pa bazuara dhe i ka propozuar gjykatës që i njëjti të refuzohet si i pathemeltë dhe të mbetet në fuqi urdhri përbarimor P.nr.054/21 i datës 22.02.2021.

Gjykata duke bërë shikim e shkresave të lëndës, pas vlerësimit të prapësimin të debitorit, si dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, gjeti se:

-prapësimi i debitorit është në tersi i pa bazuar.

Kreditori ka kërkuar lejimin e propozimit për përbarim sipas dokumentit autentik – faturave me numëre datës 11.11.2019,e datës 29.11.2019,i datës 31.12.2019,i datës 08.01.2020,..... i datës 07.02.2020,i datës 09.03.2020, i datës 01.04.2020,i datës 01.05.2020,i datës 01.07.2020,i datës 01.06.2020,i datës 01.08.2020, i datës 01.09.2020, i datës 01.10.2020, i datës 02.11.2020 dhe....., për borxhin e përgjithshëm në vlerë prej 2,700.00 Euro, të cila fatura rrjedhin nga Memorandum i Mirëkuptimit për Bashkëpunim të Ndërsjellët, i lidhur në mes të këtu kreditorit Kolegji “U.”, dhe këtu debitorit A. D. B.I, lidhur në muajin Gusht të vitit 2019, nënshkruar nga drejtori i kolegjit “U.”, A. B. dhe Drejtori i “A.D.Company”, A. D., që për nga natyra juridike e tyre, këto fatura i plotësojnë të gjitha kushtet për tu caktuar dhe zbatuar përbarimi në bazë të tyre, pasi që në dispozitën e nenit 21 të Ligjit për procedurën përbarimore është paraparë që *“organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton*

përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, kurse neni 29 paragrafi 1.3 parasheh që dokumente të besueshme janë edhe faturat, të cilat fatura janë të përshtatshme për përmbarrim bazuar në nenin 29 par.3 ku ceket se “dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, andaj, gjykata konstatoj se fatura e paraqitura nga kreditori së bashku me propozimin për përmbarrim, sipas të cilës fatura është lejuar urdhri përmbarrimor P.nr.054/21 të datës 22.02.2021, nga Shoqëria Përmbarrimore “Metaj Law”, me seli në Prishtinë, e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe i plotësojnë të gjitha kushtet e kërkuara me dispozitën e lartcekur për të qenë të përmbarrueshme, si dhe konstatoj se këto faturë janë paraqitur në origjinal, konform nenit 38 par.1 lidhur me nenin 40 par.1 pika.1.3 të LPP-së, e po ashtu gjykata gjeti se debitori faturat me numër të datës 1111.2019 dhe të datës 29.11.2019 i ka pranuar duke bërë nënshkrimin e tyre, ndërsa faturat tjera i ka pranuar përmes email-it, çka vërtetohet nga komunikimet e bëra nga debitori dhe kreditori përmes email-it, të cilët janë pjesë e shkresave të lëndës. Andaj nga të lartcekurat, gjykata e mori si të pabazuar pretendimin e debitorit se fatura nuk i përmbush kushtet për ekzekutimin e përmbarrimit.

Pretendimin e debitorit se përmbarrimi nuk mund të lejohet nëse nuk specifikohet saktë se cilat fatura janë paguar e cilat fatura nuk janë paguar, gjykata e mori si të pabazuar, pasi që shuma e përgjithshme e faturave përmbarrimin e të cilave e ka kërkuar kreditori është 14,850.00.-€, ndërsa kreditori ka kërkuar shumën prej 7,900.00.-€, duke pranuar që debitori ka përmbushur pjesën tjetër të borxhit përtej shumës që e ka kërkuar, por pa mundur të specifikoj se për cilat fatura ka përmbushur borxhin, andaj duke qenë se shuma e kërkuar është më e ulët se shuma e përgjithshme e faturave, gjykata vlerësoi se nuk është pengës që të kërkohet përmbarrimi në shumë prej 7,900.00.-€.

Gjykata aktvendimin përkitazi me refuzimin në rastin konkret e ka mbështetur edhe në nenin 71 par.1 të LPP-së, pasi që gjeti se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk hyjnë në shkaqet e parapara në këtë dispozitë, të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarrimin e lejuar, si dhe në nenin 69 par.4 në të cilin theksohet se “baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”, pasi që debitori nuk ka bashkangjitur asnjë prove të vetme me të cilën do të mund të bazoheshin pretendimet e tij, të cilat mbesin vetëm deklarative.

Andaj, për arsyet e cekura me lartë, sipas dispozitës së nenit 73 par.3 të LPP-së, gjykata vendosi si në pikën I dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi Gjykata është bazuar në nenin 77 paragrafi 5 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil-
PPP.nr.125/21, me datën 22.06.2022

Numri i lëndës: 2021:055998
Datë: 23.06.2022
Numri i dokumentit: 03166388

GJYQTARJA
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.